

## Hapet thirrja për bursa studimi për studentët e UMT, në Universitetin e Malagës, Spanjë, në kuadër të Programit Erasmus+

### Kohëzgjatja e mobilitetit:

Studentët do të studiojnë në Universitetin e Malagës, Spanjë, gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2025-2026.

Kjo thirrje është pjesë e thirrjes së mobiliteteve Erasmus+ KA171, publikuar nga Universiteti i Malagës, Spanjë. (klikoni [këtu](#)).

### Kush mund të aplikojë?

- Studentët Bachelor të UMT-së që studiojnë në vitin e dytë dhe të tretë akademik;
- Studentët Master të UMT-së që studiojnë në vitin e parë dhe të dytë akademik;
- Studentë të doktoraturës.

### Nga:

- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT
- Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës (studentët duhet të kenë përfunduar semestrin e 4-të, për t'u kualifikuar)
- Fakulteti i Ekonomisë

Fushat e studimit në UMA:

<https://www.uma.es/departamentos/>

### Gjuha e Mësimdhënies:

Gjuha e mësimdhënies do të zhvillohet në anglisht.

### Bursa përfshijnë:

- Mbështetje individuale për studentët. Shuma është 850 €/muaj
- Mbështetje shtesë për shpenzimet e udhëtimit.

Ju mund të përdorni linkun online EACEA për të llogaritur distancën.

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmusplus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmusplus/tools/distance_en.htm)

| Travel distance          | Amount per participant |
|--------------------------|------------------------|
| Between 10 and 99 Km     | 20 Euros               |
| Between 100 and 499 km   | 180 Euros              |
| Between 500 and 1999 km  | 275 Euros              |
| Between 2000 and 2999 km | 360 Euros              |
| Between 3000 and 3999 km | 530 Euros              |
| Between 4000 and 7999 km | 820 Euros              |
| 8000 km or more          | 1.500 Euros            |

## Dokumentet për aplikim

### Bachelor

1. Kopje të pasaportës
2. CV (Anglisht/Spanjisht)
3. Listë Notash
4. Vërtetim Studenti
5. Letër Motivimi
6. Learning Agreement
7. Certifikatë të gjuhës Angleze ose Spanjolle

Departamentet UMA: <http://u.uma.es/cZS/>

### Master

1. Kopje të pasaportës
2. CV (Anglisht/Spanjisht)
3. Listë Notash
4. Vërtetim Studenti
5. Kopje të Diplomes Bachelor
6. Letër Motivimi
7. Certifikatë të gjuhës Angleze ose Spanjolle
8. Learning Agreement
9. Letra paraprake e pranimi/miratimit lutemi referohuni linkut  
<https://www.uma.es/relaciones-internacionales/cms/base/ver/base/basecontent/105836/coordinadores>

### PhD

1. Kopje të pasaportës
2. CV (Anglisht/Spanjisht)
3. Vërtetim Studenti
4. Kopje të Diplomes Bachelor dhe Master
5. Letër Motivimi
6. Certifikatë të gjuhës Angleze ose Spanjolle
7. Learning Agreement
8. Letra paraprake e pranimi/miratimit lutemi referohuni linkut  
<https://www.uma.es/relaciones-internacionales/cms/base/ver/base/basecontent/105836/coor>

Për të shkarkuar dokumentin Learning Agreement, lutemi referohuni [linkut](#)

- Studentët duhet të kontaktojnë për çështje akademike me koordinatorët ndërkombëtarë të UMA <http://u.uma.es/dVX/>
- Kandidatët PhD ose Master (temë diplome) që kërkojnë një mbikëqyrës për kërkimin mund të kontaktojnë:

- Departamenti i UMA: <http://u.uma.es/cZS/>
- Lista e studimeve të doktoraturës: <http://u.um>

\* *Learning Agreement* është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “*Before the mobility*”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin Metropolitan Tirana kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

**KUJDES:** Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Malages, Spanje lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë të vitit akademik 2025/2026 në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të jepni provim lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Metropolitan Tirana.

Dokumenti “*Learning Agreement*” tek seksioni “*Commitment*” firmoset nga aplikanti dhe më pas në seksionin “*sending university*” firmoset nga Përgjegjësi i Departamentit në UMT.

**Afati për aplikime: 2 Maj, 2025**

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë fizikisht dhe me e-mail në [iro-projects@umt.edu.al](mailto:iro-projects@umt.edu.al).

**UMT ju uron suksese në aplikim tuaj!**